



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE



Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.3 pika (d) të Rregullorës 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke u mbështetur në Ligjin 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Neni 11 paragrafi 11.2.

Duke pasur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikat e veprimit për mbrojtjen e familjeve të varfra.

Me qëllim të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në shkallë të dytë të kërkuesve të ndihmës sociale, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.12/2007
PËR
THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE
NË SHKALLË TË II LIDHUR ME NDIHMAT SOCIALE

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim themelimin dhe përcaktimin e rregullave të punës së komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallë të II lidhur me ndihmat sociale.

Neni 2

Themelimi i Komisionit

(1) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes këtij Udhëzimi Administrativ e autorizon Departamentin e Mirëqenies Sociale (DMS) që në emër të Ministrisë të themeloj Komisionin për Ankesa .

(2) Departamenti i Mirëqenies Sociale themelon komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallë të II lidhur me ndihmat sociale .

(3) Komisioni themelohet në bazë të nenit 11 paragrafi 11.2 të Ligjit për Skemën e Ndhmave Sociale 2003/15.

Neni 3 Përbërja e Komisionit

(1) Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Kryetari i Komisionit është Udhëheqësi i Sektorit të Ankesave në Divizionin për Ndhmë Sociale - DMS,
2. Dy anëtarë të Komisionit janë zyrtarë të DMS-së,
3. Komisioni duhet të jetë balancuar në aspektin gjinor.

Neni 4 Funksionimi i Komisionit

(1) Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallë të II lidhur me Ndhma Sociale, drejtohet nga Udhëheqësi i Sektorit të Ankesave të Divizionit të Ndhmës Sociale.

(2) Mbledhjet e Komisionit mund të mbahen vetëm nëse përbërja e komisionit është e plotë .

(3) Seancat e Komisionit të Ankesave i cakton kryetari i Komisionit sipas nevojës dhe i njofton anëtarët e Komisionit për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

(4) Me rastin e shqyrtimit të ankesës, në raste të posaçme Komisioni i Ankesave ka të drejtë të verifikoj drejtpërdrejt familjen e cila ka parashtruar ankesë.

(5) Vendimet e Komisionit do të jenë të plotfuqishme nëse për të votojnë dy anëtar të komisionit.

(6) Kryetari i Komisionit në bazë të procesverbalit të seancës së Komisionit, nxjerr dhe nënshkruan vendimet në emër të Komisionit të Ankesave.

(7) Në rastet kur ankesa ka të bëjë me vlerësimet e Komisionit Mjekësor, atëherë Komisioni për Ankesa do të kërkojë nga Komisioni i Mjekëve i shkallës së dytë i cili është i autorizuar nga MPMS-ja, që ta shqyrtoj aspektin mjekësor të ankesës.

(8) Vlerësimi i lëndës nga komisioni mjekësor i shkallës së dytë do të jetë bazë për nxjerrjen e vendimit nga Komisioni i Ankesave i shkallës së dytë.

Neni 5

Mandati i anëtarëve të Komisionit

- (1) Komisioni themelohet me mandat dy vjeçar .
- (2) Kryetarin i komisionit ka mandat të përhershëm i cili njëherit është edhe Udhëheqës i Sektorit të Ankesave.
- (3) Anëtarët e komisionit kanë mandat dy (2) vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër .
- (4) Nëse një anëtarë i komisionit dështon që t'i kryej punët profesionale që rrjedhin nga rregulloret e komisionit dhe pas shqyrtimit të gjitha fakteve, anëtarët e komisionit mund të propozojnë përjashtimin dhe zëvendësimin e tij me një anëtarë tjetër.
- (5) Vendimin definitiv për përjashtimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të komisionit e bënë kryesuesi i DMS-së.
- (6) Në të gjitha rastet kur pushon mandati i një anëtari i komisionit, atëherë emërohet anëtari i ri për kohën e mbetur të mandatit të anëtarit të cilin e zëvendëson .

Neni 6

Procedurat për shqyrtimin e ankesave

- (1) Kërkuesi i ndihmës sociale ose përfaqësuesi i autorizuar i tij i cili mendon se i është bërë e pa drejtë me vendimin e organit të shkallës së parë për njohjen e së drejtës në ndihmë sociale, ka të drejtën të paraqesë ankesën Komisionit të Ankesave të shkallës së dytë i cili punon dhe vepron në kuadër të Departamentit të Mirëqenies Sociale të MPMS-së .
- (2) Afati për paraqitjen e ankesës në Komisionin e Ankesave në shkallën e II është 14 ditë nga dita që e marrjes së vendimit .
- (5) Të gjitha ankesat për Komisionin e Ankesave të shkallës së dytë duhet të përcillen përmes Qendrës për Punë Sociale si organ i shkallës së parë.
- (4) Komisioni i Ankesave shqyrton ankesën dhe dokumentacionin relevant dhe njofton me shkrim parashtruesin e ankesës për vendimin e marrë jo më vonë se njëzet e një (21) ditë pas marrjes së ankesës.
- (5) Vendimi i komisionit të shkallës së dytë i dërgohet palës përmes QPS-së.

(6) Nëse ankuesi është i pakënaqur me vendimin e Komisionit për ankesa, ai mund të ankohej në Gjykatën kompetente, në afatin prej 30 ditësh nga marrja e vendimit të shkallës së II në procedurë administrative.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit të komisionit

Vendimet e Komisionit të Ankesave të shkallës së dytë janë të detyrueshme për organin e shkallës së parë, Qendrat për Punë Sociale, që këto vendime të zbatohen në afatet e përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit për Procedurë Administrative.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministri i MPMS-së

Ibrahim Selmanaj

Datë: 13.11.2007

Prishtinë